

# REGJISTRI I KERKESAVE DHE PERGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	02.04.2026	Përsëndetje, kërkoj nga ju një fotokopje të dosjes me numër F 1 V.2015 D 26 FL.208-209. Jam mbesa e . Me respekt	16.04.2026	Përsëndetje, Këto janë dokumentet që ka ISKK për . Dokumentet janë në formë elektronike (foto). Kërkesë nga ISKK: ISKK është i interesuar të dijë nëse mbiemri e ka pasur mbiemër gjithë fisi i Rizait, apo vetëm ai e ka përdorur? Nëse është kështu, mund të na thoni cili është mbiemri i familjes? Veç kësaj, nëse keni ose na gjeni dot një fotografi të pllakës që ka qenë në anë të rrugës, poshtë Prongjisë, që tregonte për vrasjen e , do t'u ishim mirënjohës. Kjo kërkesë bëhet për të plotësuar informacionin rreth kësaj figure, për të cilin do të flitet në botime të ISKK. Duke ju falenderuar, Me respekt, ISKK	E plotë	Nuk ka
2	18.01.2026	Të nderuar, Ju shkruaj për të pyetur nëse libri "Kalvari i grave në burgjet e komunizmit" nga Fatbardha Saraçi (Mulleti) është aktualisht i disponueshëm për blerje dhe si mund të sigurohet. Ju falenderoj paraprakisht. Me respekt,	21.01.2026	Përsëndetje Znj! Më lejoni t'ju informoj se botimet e publikuara nga Instituti ynë nuk ofrohen kundrejt pagesave, blerjeve. Ato mund të aksesohen në çdo bibliotekë të vendit ose të merren falas pranë ISKK. Ky libër fatkeqësisht nuk ka më kopje për tu shpërndarë nga ne por nëse ju vullt mund t'ua dërgojmë elektronikisht në dokument PDF. Theksojmë se është e ndaluar shpërndarja juaj e këtij dokumenti. Mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj. Ditë të mbarë!	Jo e plotë	Nuk ka
3	21.01.2026	Përsëndetje, Ju falenderoj shumë për përgjigjen dhe informacionin e dhënë. Do të isha shumë e lumtur ta kisha librin, qoftë dhe në format elektronik (PDF), nëse kjo është e mundur për ju. Kuptoj dhe respektoj plotësisht të drejtën e autorit dhe ju siguroj se dokumenti do të përdoret vetëm për lexim personal, pa asnjë qëllim apo motiv tjetër dhe pa u shpërndarë në asnjë formë. Ju falenderoj paraprakisht për gatishmërinë dhe mbetem në pritje të përgjigjes tuaj. Me respekt,	22.01.2026	Përsëndetje! Gjeni bashkëlidhur librin e autores Fatbardha Saraçi, për të cilin bëte kërkesë. Lexim të mbarë!	E plotë	Nuk ka
4	27.02.2026	Ladies and Gentlemen, My name is . I work for TVP Sport, the Polish equivalent of the BBC. I'm working on a piece about footballer Skënder Ahmet Halili, born on August 20,1940. In August 1996, he was arrested before the 17 Nëntori - Valerenga Oslo match. I wanted to ask if you have any materials about this footballer and if i could share them. Sincerely,	11.03.2026	Hello Mr., Based on our research, Mr. Skënder Ahmet Halili is not part of the publications of the Encyclopedic Dictionary of Victims of Communist Terror nor in the database of the Institute of Integration of Former Political Victims. The only article that mentions his arrest is found in the link below: <a href="https://www.gazetatema.net/2016/07/22/skender-halili-si-u-arrestua-nga-sigurimi-pse-refuzoi-dinamon/">https://www.gazetatema.net/2016/07/22/skender-halili-si-u-arrestua-nga-sigurimi-pse-refuzoi-dinamon/</a> . Since it was mentioned by the newspaper Tema, you can do a search at the Authority for Information on the Documents of the Former State Security (AIDSSH). Kind regards	E plotë	Nuk ka
5	04.03.2026	Të nderuar Zonja dhe Zotërinj! Mbjaj mend që në faqen tuaj të vjetër gjendeshin vëllimet e këtij fjalori enciklopedik. Tashmë shoh që keni një faqe të re, te rubrika e botimeve shfaqet seksioni i fjalorit; megjithatë, kur klikohet mbi të, nuk hapet asgjë. Në kërkimin Google gjenden vetëm disa vëllime si PDF (rreth tre). Dotë isha shumë i interesuar të kisha qasje në të gjithë databazën e plotë, përtej këtyre pak vëllimeve që shfaqen në kërkim, për shembull: <a href="https://www.iskk.gov.al/wp-content/uploads/2017/03/fjalori-ok-enciklopedik-IV-1.pdf">https://www.iskk.gov.al/wp-content/uploads/2017/03/fjalori-ok-enciklopedik-IV-1.pdf</a> Ju falenderoj paraprakisht për përgjigjen tuaj. Me respekt,	11.03.2026	I nderuar Dr., Databaza e plotë e Fjalorit Enciklopedik, mund të konsultohet në mjediset e ISKK, ndërsa 12 vëllimet e Fjalorit janë botuar dhe janë të shfrytëzueshme edhe janë pjesë e rrjetit të bibliotekave, mjafton të respektohet citimi i burimit. Për zëra të veçantë të këtij fjalori që ju jeni të interesuar mund t'ju vëmë në dispozicion në adresën tuaj elektronike. Punë të mbarë!	E plotë	Nuk ka
6	01.04.2026	Të nderuar, quhem dhe jam studente në programin Master (Histori) në Universitetin Teknik në Braunschweig, në Gjermani. Aktualisht jam duke shkruar punimin tim të masterit mbi përpunimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri, me fokus të veçantë në rolin e institucioneve si AIDSSH. Për analizën time përdor disa kritere dhe do të isha shumë mirënjohës nëse do të mund të më ndihmonit me disa informacione të shkurtra: * Cilat janë temat kryesore në punën tuaj? * Çfarë narrativash apo prespektivash mbi të kaluarën komuniste theksohen më shumë? * Cilat janë grupet kryesore që synoni (p.sh. studiues, të rinj, publiku i gjërë)? * Në çfarë formash zhvillohet puna juaj (publikime, ekspozita, aktivitete edukative)? * Çfarë sfidash apo vështirësishë hasni në procesin e përpunimit të së kaluarës? E kuptoj që jeni të zënë, ndaj edhe përgjigjet e shkurtra apo referenca drejt materialeve ekzistuese do të më ndihmonin shumë. Ju falenderoj shumë për kohën dhe mbështetjen tuaj. Me respekt,	01.04.2026	Përsëndetje Znj., Duke ju referuar emailit tuaj ju informojmë se Institucioni ynë është Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit. AIDSSH është një tjetër autoritet dhe nëse ju nevojitet informacion rreth tyre mund t'i kontaktoni drejtëpërdrejtë në adresën e tyre elektronike zyrtare. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, ISKK	E plotë	Nuk ka
7	01.04.2026	I nderuar Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK), Une quhem dhe po kërkoj informacion historik mbi familjen time dhe ngjarjet tragjike që ndodhën në fshatin Prosek-Rrëshen rreth viteve 1949-1955. Saktësisht: * Gjyshja ime ishte femijë në atë periudhë, me moshë rreth 5-8 vjeç. * Dy femijë të vegjël të familjes (mosha rreth 13-14 vjeç) u vranë nga forcat e kohës, dhe më pas gjyshja ime së bashku me motrat e saj dhe nënën u dërguan në burgun e Tepelenës. * Kam dëgjuar vetëm histori gojore dhe dëshiroj të mësoj çfarë ndodhi realisht, çfarë është raportuar në mediat e kohës dhe dokumentet zyrtare, dhe përse ndodhi kjo tragjedi. Do të isha shumë mirënjohëse nëse mund të më orientoni drejt dokumenteve, arkivave ose burimeve ku mund të mësoj më shumë për këto ngjarje. Faleminderit shumë për kohën dhe ndihmën tuaj. Me respekt,	09.04.2026	Përsëndetje Znj., Pasi lexuam emailin tuaj na lejoni t'ju informojmë se për kampin e Tepelenës fatkeqësisht informacioni i administruar tek ne është pak i cunguar. Gjithsesi ju lutemi na dërgoni një informacion më të detajuar (emër, mbiemër etj) për familjarët tuaj që kanë vuajtur në këtë kamp dhe ne t'ju dërgojmë një përgjigje me çfarë mund t'ju ndihmojmë. Duke ju uruar më të mirat, ISKK	E plotë	Nuk ka
8	19.03.2026	Unë që po ju shkruaj quhem 23 vjeçe, kam përfunduar studimet Master i Shkencave për Teori dhe Kritikë Letrare me një mesatare maksimale kurse studimet Bachelor i kam përfunduar për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë.  Arsyeja që vendosa t'ju dërgoj këtë email është se dua të shpreh interesin tim të drejtëpërdrejt për tu angazhuar pranë institucionit tuaj. Nisem nga fakti se kam një mesatare ekselente, po ashtu është një institucion që përkon me fushën time të studimit, di t'ju garantoj që jam e pajisur me aftësi të forta kërkimore, analitike, elokuentë duke qënë që përgjate 5 viteve kam pasur mundësinë të prek me anë të degës ku kam studiuar çdo kulturë, mendimësi dhe art të shkruarit që ajo ofron. Besoj që këto aftësi mund të ishin një bonus në kërkimet tuaja.  Po ashtu mu komunikua që kërkoni staf (nuk e di sa e vërtetë është) dhe vendosa t'ju shkruaj pasi jam e interesuar nëse do të më konsideroni. (nëse dëshironi ju parashtrij një CV ju lutem mos hezitoni të ma kërkon)  Uroj të kem një përgjigje nga ju sido të jetë ajo.  Me respekt,	26.03.2026	E nderuar znj., Ju falënderojmë për interesin e shprehur ndaj Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK), si edhe për prezantimin tuaj dhe arritjet akademike. Vlerësojmë motivimin dhe përgatitjen tuaj në fushën e studimeve letrare, si dhe dëshirën për t'u angazhuar në një institucion që lidhet me profilin tuaj profesional. Dëshirojmë t'ju informojmë se, për çdo mundësi punësimi apo angazhimi pranë ISKK, njoftimet publikohen në mënyrë të vazhdueshme në faqen zyrtare të institucionit. Në këtë kuadër, ju ftojme që gjatë kësaj periudhe të konsultoni herë pas here portalin zyrtar <a href="http://www.iskk.gov.al">www.iskk.gov.al</a> , në rubrikën "Vende vakante", për t'u njohur me çdo shpallje të mundshme. Ju falënderojmë edhe njëherë për interesin dhe ju urojmë suksese në rrugëtimin tuaj profesional. Me respekt, Iskk	E plotë	Nuk ka